



- [Të reja](#) [Kush jemi](#) [Historiku](#) [Shërbime](#) [Baza ligjore](#) [Vendndodhjet](#) [Video](#) [Programi i transparencës](#) [Kontakt](#)
- [Denonco Krimin Kibernetik](#) [Drejtoritë Vendore](#) [Policia Kufitare](#) [Policia Rrugore](#) [Donacione](#) [Policimi në Komunitet](#)
- [Përmbledhja Mujore](#) [Për sinjalizimin](#) [Të Guximshëm pa Armë](#)

Breaking News:

Raporti ditor i ngjarjeve, 28 gusht 2025



28/08/2025

Tiranë/Goditet Një Rast I Shitjes Së Lëndës Narkotike, Në Doza

Tiranë/Goditet nga Komisariati i Policisë Nr. 3 në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve, një rast i shitjes së lëndës narkotike, në doza.

Kapen në flagrancë dhe vihen në pranga 2 shtetas që bashkëpunonin për shitjen e dozave të Kokainës dhe Cannabisit.

Sekuestrohen sasi/doza Kokaine dhe Cannabis, 2 mjete prerëse (thika) dhe 2 pistoleta sportive.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 3, bazuar në informacionet e siguruar për një rast të shitjes së lëndëve narkotike, në doza, kanë intensifikuar kontrollet për goditjen e këtij rasti dhe vënien e autorëve në pranga.

Si rezultat, në bashkëpunim dhe me Seksionin e Narkotikëve u kapën në flagrancë në rrugën “Mahmut Bobrati” dhe u arrestuan shtetasit:

-E. F., 43 vjeç dhe I. K., 37 vjeç, të dy banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit, shërbimet e Policisë i kanë gjetur këtyre dy shtetasve, sasi dhe doza të lëndëve të dyshuara narkotike Kokainë dhe Cannabis, 2 mjete prerëse (thika) dhe 2 pistoleta sportive, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Nga hetimet dyshohet se këta shtetas, pasi siguronin lëndë narkotike, e ndanin në doza në një ambient në përdorim nga shtetasi E. F. dhe më pas i shitnin ato në zona të ndryshme të Tiranës.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.



Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Korçë/Kreu parakalim të gabuar, ndëshkohet me masë administrative, drejtuesi i automjetit

Policia e Shtetit/Finalizohet operacioni policor i koduar “Hapësira publike” ▶